

Programi Fulbright për Studime Master [Fulbright Foreign Student program](#) është një program një ose dy vjeçar për profesionistë të rinj dhe ata që kanë përfunduar studimet, të interesuar të ndjekin studime në nivelin Master në Shtetet e Bashkuara.

FUSHAT E STUDIMIT:

I. Bursat Fulbright të financuara nga Departamenti i Shtetit, -- **janë të hapura për të gjitha fushat e studimit**

II. Bursat Fulbright me financim nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë – **janë të hapura për keto fusha**

- STEM (Shkenca, Teknologji, Fizikë, Matematikë)
- Bujqësi dhe Shkenca Jetësore (Bujqësi e qëndrueshme dhe menaxhim i burimeve; Menaxhimi i Sistemeve Bujqësore; Edukim Bujqësor; Menaxhimi i Agrobiznesit; Ekonomia Bujqësore; Inxhinieri Bujqësore dhe Biologjike; Ushqyerja e Kafshëve; Biokimi, Biologji Molekulare, Entomologji dhe Patologji Bimore)
- Shkencat e Kafshëve të Egra dhe Peshkimit (Konservimi dhe biologjia e kafshëve të egra; Biologjia e Peshkimit dhe Ruajtja e Jetës së Egër)
- Shkenca Pyjore (Shkenca Mjedisore dhe Pylltari, Inxhinieri Pyjore, Shkenca e Drurit)
- Turizmi (Menaxhimi i Turizmit; Menaxhimi i Mikpritjes dhe Turizmit; Turizmi i Trashëgimisë dhe Konservimi)
- Shkenca e Inxhinierisë së Mjedisit (Inxhinieria e Burimeve Mjedisore, Inxhinieria Ekologjike, Menaxhimi i Mjedisit, Inxhinieria e Burimeve Mjedisore)
- Inxhinieri (Inxhinieri Minierash dhe Gjeologjike, Inxhinieri Kimike, Inxhinieri Bioprocesimi, Menaxhimi i Inxhinierisë së Qëndrueshme)
- Bio – Kimi (Biokimi, Kimi Mjedisore, Kimi Organike e Produkteve Natyrore, Biologji Mjedisore, Ekologji Kimike, Bioteknologji Mjedisore, Shkenca bimore)

KRITERET PËR APLIKIM

Aplikantët duhet:

- të jenë qytetarë të Republikës së Shqipërisë.
- të kenë të paktën një diplomë të nivelit Bachelor nga një program studimi me kohë të plotë katër vjeçar (ose diplomë të programeve tre + një ose tre + dy, sipas sistemit të Bolonjës).
- të kenë të paktën dy vjet përvojë profesionale pune në fushën e studimit dhe të shfaqin aftësi udhëheqëse

- Aplikantët duhet të kenë një nivel të mirë të gjuhës angleze të folur dhe të shkruar (ekuivalente të nivelit B2 – minimum 82 pikë; rezultatet e provimit të TOEFL nuk janë të detyrueshme në momentin e aplikimit.)
- të kualifikohen për të marrë vizë J-1.
- të kenë rekorde të mira shëndetësore.

*** Kandidatët janë të detyruar të kthehen në Shqipëri për të paktën dy (2) vjet në përfundim të programit.

Për më shumë informacion, të interesuarit mund të klikojnë në [Fulbright Student Program 2024-2025 - U.S. Embassy in Albania \(usembassy.gov\)](#)

AFATI I APLIKIMIT: 15 korrik 2023

Për pyetje të tjera mund të kontaktojne në: CultureandEducationTirana@State.Gov